



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0025

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, duke vendosur sipas ankesës së OE Roza Komani B.I., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II” me numër të prokurimit 634-25-10539-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Klinë, më 20.02.2026, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Roza Komani” B.I. me nr. 2026/0025, e datës 09.01.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II”, me numër të prokurimit; 634-25-10539-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues, Komuna Klinë.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, - Komuna Klinë për aktivitetin e prokurimit “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II”, me numër të prokurimit 634-25-10539-5-2-1.
3. Bazuar në nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues OE “Roza Komani” B.I, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të tarifës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 20.11.2025 Komuna Klinë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin e prokurimit “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne

QKMF dhe AMF faza II” me numër të prokurimit 634-25-10539-5-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 55,000.00€.

Me 24.12.2025 Komuna Klinë, duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi vendimin (B58), ku është rekomanduar për kontratë OE LURN SH.P.K.

Me 29.12.2025, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku me datë 31.12.2025 AK e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim

Me 09.01.2026, OE Roza Komani B.I., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokoli 2026/0025, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për dhënie të kontratës.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Roza Komani B.I., janë parashtruar si në vijim:

Duke u mbështetur në ligjet në fuqi dhe duke i respektuar afatet kohore të lejuara sipas LPP, po e paraqesim këtë Ankesë pranë OSHP-së, sipas Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, në pajtim me Nenin 108/A, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, që adopton rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për paraqitje të ankesës pranë OSHP.

Nuk pajtohem me vendimin e AK KK Klinë të datës 24.12.2025, në lidhje me projektin: Titulli Renovim dhe rindërtim i hapësirave në QKMF dhe AMF faza II.

Fakte dhe argumente 1:

Fillimisht po citojmë arsyetimin e eliminimit: Licencë nga MPMS për menaxherin e projektit si dhe nuk ka ofruar certifikatë si instruktor në vendin e punës për inxhinierin e ndërtimtarisë sipas kërkesës në DT. Nuk i ka përmbushur kërkesat për makineri: Makina për suvatim duhet doganor në Ndue Komani - nuk ka marrëveshje shfrytëzimi për aparat saldimi dhe matës të tokëzimit nuk ofrohen dëshmi të mjaftueshme, për kontejner 15 m2 nuk ofrohen dëshmi të hapësirës.

Ne nuk pajtohem me këtë arsyetim të eliminimit, për arsyet si më poshtë:

Arsyetimi nr. 1 - Staf i profesional

Inxhinieri i arkitekturës, z. Albert Shehu, është i pajisur me të gjitha diplomat dhe certifikatat e kërkuara nga ana juaj, madje edhe më shumë se sa kërkohet në DT. Ky inxhinier ka përvojë të konsiderueshme profesionale dhe gjatë karrierës së tij është pajisur me kualifikime shtesë që

tejkalojnë kriteret minimale të përcaktuara. Sipas Ligjit për siguri dhe shëndet në punë 04/L-161, një person mund të pajiset me certifikatë për siguri dhe mbrojtje në punë nga MPMS dhe/apo nga një ekspert apo institucion i certifikuar nga MPMS, të cilit i është dhënë e drejta të trajnojë persona të tjerë për siguri dhe mbrojtje në punë. Inxhinieri i paraqitur nga ne i ka certifikatat e kërkuara nga AK, të cilat AK nuk i ka marrë për bazë. E njëjta vlen edhe për secilin inxhinier tjetër të paraqitur nga ana jonë.

Megjithatë, nëse do të ishte respektuar neni 59 i LPP-së dhe do të ishte kryer vlerësimi në mënyrë të drejtë dhe të plotë, atëherë, në përputhje me nenin 72 të LPP-së, do të duhej të kërkoreshin informata apo sqarime shtesë lidhur me dokumentacionin e ngarkuar. Kjo nuk ka ndodhur, pasi keni arritur në një përfundim të menjëhershëm, pa respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Arsyetimi nr. 2 - Pajisjet dhe makineria

Sa i përket pajisjeve dhe arsyetimit tuaj, sërish nuk pajtohem.

Makina për suvatim është në emër të z. Ndue Komani, i cili njëkohësisht është edhe drejtor i kompanisë. Është vërejtur se ka ndodhur një gabim teknik, pasi nuk është ngarkuar kontrata e shfrytëzimit e lidhur ndërmjet drejtorit z. Ndue Komani dhe kompanisë Roza Komani B.I.

Sa i përket aparatit të saldimit dhe matësit të tokëzimit, janë ofruar dëshmi në përputhje të plotë me kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për Kontratë. Duke pasur parasysh se në DT dhe në Njoftimin për Kontratë është lejuar si dëshmi fatura, e njëjta është ofruar edhe nga ana jonë. Prandaj, refuzimi i një dokumentacioni që është shprehimisht i lejuar në DT është i pajustificuar.

Gjithashtu, sa i përket matësit të tokëzimit, pas analizimit të paramasës së projektit në fjalë, nuk është konstatuar asnjë pozicion që lidhet me shpërndarjen e shiritave të tokëzimit, tokëzimin apo matjen e tokëzimit. Në rast se lind nevoja për matje të tokëzimit, kjo mund të caktohet nga menaxheri i projektit dhe të realizohet si punë shtesë, duke angazhuar kompani profesionale për matjen e rezistencës së tokëzimit. Megjithatë, matësi i tokëzimit është i prezantuar me faturën nr. 94-2025, datë 09.12.2025, e cila gjendet në listën nr. 10 - Makineria 2, pozicionet 8 dhe 9 (Aparat saldimi & Matës tokëzimi - Korben), me markë dhe tip të specifikuar. Në dosjen e tenderit nuk janë kërkuar dëshmi apo specifika shtesë, përveç “një aparat matës të rezistencës së tokëzimit”.

Kontejneri 15 m2

Sa i përket kontejnerit 15 m2, ai është prezantuar dhe gjendet në listën nr. 10 - Makineria 2, pozicioni 11 (Kontejner - PEVLAKU), me marrëveshje shfrytëzimi. Në marrëveshje është cekur qartë se kontejneri ka përmasa 6 m x 2.6 m. Duhet theksuar se, varësisht nga dokumentacioni doganor, specifikohen të gjitha të dhënat relevante të pajisjeve.

Vlen të theksohet që OE të cilin kanë favorizuar si OE i përgjegjshëm, ing. i Arkitekturës Masar Kabashi, ka një licencë nga MPMS por të vitit 2019, gjë që është e skaduar. Dhe AK ka marrë si të mirëqenë atë licencë duke mos i kontrolluar afatet kohore dhe vlefshmërinë e dokumentit.

Trajtimi i pabarabartë dhe shkeljet ligjore

Për secilën arsye të eliminimit, në rast të paqartësive, keni pasur mundësi të respektoni nenin 72 të LPP-së duke kërkuar sqarime shtesë, si dhe nenin 7 të LPP-së duke na trajtuar në mënyrë të

barabartë me operatorët e tjerë ekonomikë. Kjo nuk ka ndodhur.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të operatorit ekonomik të shpallur fitues, konstatojmë trajtim të pabarabartë ndaj dy operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.

Fakt konkret

Sipas Dosjes së Tenderit është kërkuar listë e stafit me së paku 15 punëtorë, përfshirë personel të kualifikuar, ndër të cilët edhe: teknik i arkitekturës, teknik i ndërtimtarisë (drejtimi hidro), teknik i makinerisë dhe teknik elektrikist.

Operatori ekonomik i shpallur fitues ka prezantuar:

- Z. Besart Hasanaj si “Teknik i makinerisë”, ndërkohë që diploma dhe certifikata e tij janë në profilin “mekanik i makinave”, që nuk përputhet me kërkesën e DT-së, pasi tenderi nuk ka të bëjë me servis makinash, por me renovime dhe rindërtime objektsh.
- Znj. Donjetë Metaj si “Elektrikist”, ndërkohë që diploma e saj është në profilin e elektroenergjetikës, që nuk përmbush kërkesën për teknik elektrikist, pasi këto janë profile profesionale të ndryshme.

Këto lëshime janë toleruar tek operatori ekonomik fitues, gjë që tregon qartë trajtim selektiv dhe të pabarabartë.

Përfundim

Gjithashtu, me eliminimin tonë është shkaktuar dëm buxhetor në vlerë prej 1,572.65 €, pasi ne kemi qenë operator ekonomik i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët, ndërsa është propozuar për kontratë një operator më i shtrenjtë dhe i papërgjegjshëm.

Në	këtë	rast	janë	shkelur:
• neni 7	(trajtim	i	barabartë),	
• neni 59	(vlerësimi	i	ofertave),	
• neni 72	(moskërkimi	i	sqarimeve),	

• si dhe nenet 1 dhe 2 të LPP-së, lidhur me përdorimin efikas të fondeve publike dhe respektimin e ligjit.

Për këto arsye, kërkojmë rishqyrtimin e vendimit dhe anulimin e eliminimit tonë, në përputhje me ligjin në fuqi. PRA KËRKOJMË TË MERRET

Përgjigje në kërkesën për rishqyrtim:

Pretendimi 1

Arsyetimi nr. 1 - Stafi profesional

Inxhinieri i arkitekturës, z. Albert Shehu, është i pajisur me të gjitha diplomat dhe certifikatat e kërkuara nga ana juaj, madje edhe më shumë se sa kërkohet në DT. Ky inxhinier ka përvojë të konsiderueshme profesionale dhe gjatë karrierës së tij është pajisur me kualifikime shtesë që tejkalojnë kriteret minimale të përcaktuara. E njëjta vlen edhe për secilin inxhinier tjetër të paraqitur nga ana jonë. Megjithatë, nëse do të ishte respektuar neni 59 i LPP-së dhe do të ishte kryer vlerësimi në mënyrë të drejtë dhe të plotë, atëherë, në përputhje me nenin 72 të LPP-së, do të duhej të kërkoheshin informata apo sqarime shtesë lidhur me dokumentacionin e ngarkuar.

Kjo nuk ka ndodhur, pasi keni arritur në një përfundim të menjëhershëm, pa respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

Përgjigje në pretendimin 1

Një menaxher i projektit kërkohet të jetë inxhinier (master) i diplomuar i arkitekturës, me pesë vite përvojë pune në fushën e njëjtë ose të ngjashme dhe të jetë i licencuar, të jetë i trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë pranë MPMS-së. Kërkesa juaj është pa bazë, pasi certifikata për siguri dhe shëndet në punë nuk është nga MPMS, siç është kërkuar në DT.

Pretendimi 2

Arsyetimi nr. 2 - Pajisjet dhe makineria

Sa i përket pajisjeve dhe arsyetimit tuaj, sërish nuk pajtohem. Makina për suvatim është në emër të z. Ndue Komani, i cili njëkohësisht është edhe drejtor i kompanisë. Është vërejtur se ka ndodhur një gabim teknik, pasi nuk është ngarkuar kontrata e shfrytëzimit e lidhur ndërmjet drejtorit z. Ndue Komani dhe kompanisë Roza Komani B.I. Sa i përket aparatit të saldimit dhe matësit të tokëzimit, janë ofruar dëshmi në përputhje të plotë me kërkesat e DT-së dhe Njoftimit për Kontratë. Duke pasur parasysh se në DT dhe në Njoftimin për Kontratë është lejuar si dëshmi fatura, e njëjta është ofruar edhe nga ana jonë. Prandaj, refuzimi i një dokumentacioni që është shprehimisht i lejuar në DT është i pajustificuar. Gjithashtu, sa i përket matësit të tokëzimit, pas analizimit të paramasës së projektit në fjalë, nuk është konstatuar asnjë pozicion që lidhet me shpërndarjen e shiritave të tokëzimit, tokëzimin apo matjen e tokëzimit. Në rast se lind nevoja për matje të tokëzimit, kjo mund të caktohet nga menaxheri i projektit dhe të realizohet si punë shtesë, duke angazhuar kompani profesionale për matjen e rezistencës së tokëzimit. Megjithatë, matësi i tokëzimit është i prezantuar me faturën nr. 94-2025, datë 09.12.2025, e cila gjendet në 5/3 F02 Formulari Standard për rishqyrtim të vendimit në AK, listën nr. 10 - Makineria 2, pozicionet 8 dhe 9 (Aparat saldimit & Matës tokëzimi - Korben), me markë dhe tip të specifikuar. Në dosjen e tenderit nuk janë kërkuar dëshmi apo specifika shtesë, përveç "një aparat matës të rezistencës së tokëzimit".

Përgjigje në pretendimin 2

Sa i përket mjeteve të tjera (B) të punës të përshkruara në dosje të tenderit, të ofrohet si dëshmi dudinë doganore ose fatura me transaksion bankar mbi shitblerje, nëse është ndërruar titullari i mjetit, të cilat janë kërkuar për realizimin e këtij projekti. Pajisjet dhe makineria, sa i përket pajisjeve dhe arsyetimit tuaj, sërish nuk pajtohem. Makina për suvatim është në emër të z. Ndue Komani, i cili njëkohësisht është edhe drejtor i kompanisë. Është vërejtur se ka ndodhur një gabim teknik, pasi nuk është ngarkuar kontrata e shfrytëzimit e lidhur ndërmjet drejtorit z. Ndue Komani dhe kompanisë Roza Komani B.I. Ashtu siç e keni cekur edhe ju që është gabim teknik, po për ne si AK është e nevojshme që çdo dokumentacion i kërkuar sipas DT duhet të bashkëngjitet në ofertën tuaj. Ndërsa aparat saldimit si dhe matës tokëzimi keni të bashkëngjitur faturë, por jo sipas DT me transaksion bankar, që edhe vërteton që është në pronësi tuaj.

Pretendimi 3

Kontejneri 15 m2

Sa i përket kontejnerit 15 m2, ai është prezantuar dhe gjendet në listën nr. 10 - Makineria 2, pozicioni 11 (Kontejner – PEVLAKU), me marrëveshje shfrytëzimi. Në marrëveshje është cekur

qartë se kontejneri ka përmasa 6 m × 2.6 m. Duhet theksuar se, varësisht nga dokumentacioni doganor, specifikohen të gjitha të dhënat relevante të pajisjeve.

Përgjigje në pretendimin 3

Kontejneri 15 m2, sa i përket kontejnerit 15 m2, në dud është bashkëngjitur kontejner me 6 ml, nuk ka të bashkëngjitur dokumentacion që vërteton që është 15 m2.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtrës dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 15.01.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0025, ndërsa me datë 26.01.2025 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Lidhur me pretendimet e OE Roza Komani B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0025 ka vlerësuar si në vijim:

Aktiviteti i prokurimit me titull: “Renovim dhe rindërtim i hapësirave në QKMF dhe AMF faza II” me nr. të prokurimit: "634-25-10539-5-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KUVENDI KOMUNAL I KLINËS, procedurë e hapur, lloji i kontratës punë, kriteri çmimi më i ulët i përgjegjshëm.

Ankesa është e parashtruar kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues, i cili rekomandon për kontratë Lurn SHPK ndërsa Operatorin Ekonomik (OE) ankues e eliminon me arsyetimin:

ARSYETIM

Ju në ofertën tuaj nuk keni prezantuar dokumentet sipas kërkesës në dosje të tenderit:

Licencë MPMS për menaxherin e projektit si dhe nuk ka ofruar Certifikatë si instruktor në vendin e punës për inxhinierin e ndërtimtarisë sipas kërkesës në DT. Nuk i ka përmbushur kërkesat në makineri: Makina për suvatim Dudi Doganor më emër të Ndue Komani-nuk ka marrëveshje shfrytëzimi, për aparat saldues dhe matës të tokëzimit nuk ofrohen dëshmi të mjaftueshme, për kontejner 15m2 nuk ofrohen dëshmi të hapësirës.

Rrjedhimisht OE ankues pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues (AK), i njëjti ka parashtruar ankesë pranë OSHP-së, duke pretenduar se AK nuk ka vlerësuar

drejtë ofertat dhe se është i përgjegjshëm. Dispozitat e pretenduara të shkelura të Ligjit për Prokurim Publik janë: neni 1,2,7,59,72.

Tutje, OE ankues në ankesë ka parashtruar pretendime ankimore kundër arsyes së eliminimit, i cili pretendon se i plotëson kërkesat,

Pretendimi i OE ankues, arsyeja e eliminimit:

O.E Roza Komani B.I. nuk ka ofruar Licens nga MPMS per menaxherin e projektit si dhe nuk ka ofruar Çertifikate si instruktor ne vendin e punes per inxhinierin e ndertimtarise sipas kerkeses ne DT, nuk i ka permbushur kerkesat per makineri: Makina per suavitim dudi doganor me emer te Ndue Komnani- nuk ka marreveshje shfrytezimi, per aparat saldues dhe mates te tokezimit nuk ofrohen deshmi te mjaftueshme, per kontinier 15m2 nuk ofrohen deshmi te hapersires.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues:

Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës të dokumentuara në E-prokurim sqaron se, Autoriteti Kontraktues në dosje të tenderit si kërkesë të parë ka kërkuar:

Kërkesa 1. Një Menaxheri i projektit; kërkohet te jetë Inxhinier(master) i diplomuar i Arkitekturës, me pesë vite përvojë pune ne fushën e njëjtë ose te ngjashme dhe te jetë i licencuar,të jetë i trajnuar për sigurinë dhe shëndetin në punë pranë mpms-se.

Dëshmia 1-4. Për menaxherin e projektit, menaxherin e punishtes të paraqiten vendimet për përcaktimin e menaxherit të projektit dhe menaxherin e punishtes, si dhe për menaxherin e projektit, menaxherin e punishtes dhe stafin profesional, të paraqiten diplomat përkatëse. Nëse diploma është e lëshuar nga ndonjë shtet tjetër, e njëjta duhet të jetë e nostrifikuar nga MASHTI. Kopjet e kontratave ose para kontratave mbi marrëdhënien e punës, listën e projekteve që ka menaxhuar dhe CV-t e tyre të nënshkruar nga vetë personi, letër referencë për vitet dhe lëmin e kërkuar të lëshuar nga punëdhënësit pas diplomimit.

Dhe në ofertën e OE ankues gjendet Menaxheri i projektit i cili si certifikatë e kontestuar është Certifikata për siguri dhe shëndet në punë e cila është e lëshuar nga një kompani private, dhe jo nga MPMS sipas kërkesës në DT, mirëpo në anën tjetër OE ankues pohon/deklaron se kompania private është e licencuar nga MPMS për trajnimin dhe certifikimin e individëve, dhe si e tillë bazuar në shkresat e lëndës i njëjti me ankesë ka të bashkangjitur një certifikatë për një person me inicilet M.K në të cilën certifikatë shkruan Certifikatë për dhënien e Provimit Profesional nga Fusha e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, mirëpo emri nuk përkon me kompaninë e lëshimit të certifikatës së menaxherit të projektit, pra i njëjti nuk ka ofruar dëshmi lidhur me kompanin e licencuar e cila ka lëshuar certifikatën e menaxherit të projektit, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar me prova dhe fakte.

Kurse, lidhur me arsyen e dytë të eliminimit ekspertja shqyrtuese sqaron, kërkesa e AK-së është:

Kerkesa Makineria

një kamion mbi 10 ton,

- një kamion gjysmë rimorkio për bartje të makinerive,

- Minieskavator me peshe deri 990 kg-

një auto kran me kapacitet bartës min. 10 ton-

- një makine për nivelimi të estrihut,

- një makinë për suvatim,

-nje gjenerator min.6 KV ,

-nje aparat saldues,

-nje aparat matës të rezistences së tokëzimit

- Skele minimum 200m2 për mbulimin e sipërfaqes së fasadës së objektit etj.

– një kontejner min. 15m2,

- një kontejner ËC.

- Rrethoja metalike (ne sasi mjaftueshëm për rrethimin e përkohshëm te punishtes

Dëshmia Listën e mjeteve, mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe kapacitetet tjera të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit në Njoftimin për Kontratë dhe Dosje te Tenderit). Lista duhet të jetë origjinale , e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik. O.E për mjetet A) duhet të ofroj si dëshmi librezat e qarkullimit me regjistrim, ndërsa për mjetet tjera B) të punës të përshkruara në dosje të tenderit, të ofroj si dëshmi dudinë doganorë ose faturën me transaksion bankarë mbi shitblerje nëse është ndërruar titullari i mjetit, të cilat janë kërkuar për realizimin e këtij projekti.

Ndërsa në ofertën e OE ankues sa i përket Makinës për suvatim, e cila është ofruar DUD-i në emër personal të pronarit të kompanisë, këtë detaj, ekspertja shqyrtuese konsideron se mund të merret konform nenit 59.4 të LPP-së, për faktin se, shihet që është po i njëjti person, qoftë si individ apo kompani. Pretendimi i bazuar.

Tutje, arsyeja tjetër e eliminimit për Aparat Saldimi dhe matësi të rezistencës së tokëzimit, pozicionet 6 dhe 9 në listën e pajisjeve të OE ankues, ekspertja shqyrtuese sqaron se, sipas kërkesave për dëshmi nga AK, të njëjtat janë të ofruara me një faturë të blerjes, mirëpo nuk kanë dëshmi transaksionin bankar, e cila gjithashtu nuk është ofruar si dëshmi as më ankesë. Pretendimi i pa bazuar.

Kurse Kontejner 15 m2, makineria nr. 10 në DUD doganor e njëjta në specifika është shënuar kontejner i përdorur 6 ml, ndërsa në marrëveshje nuk është e specifikuar asnjë detaj i pajisjes, gjithashtu në dokumentin unik doganor nuk ka specifika 15 m2, dhe si e tillë edhe në ankesë nuk është e dëshmuar e njëjta. Pretendimi i pa bazuar.

Rrjedhimisht, OE ankues parashtro disa pretendime edhe kundër OE të rekomanduar, për të cilat ekspertja shqyrtuese sqaron se, AK në DT ka kërkuar:

Kerkesa Lista e stafit te OE, se paku (15) punëtor ne mesataren e te punësuarve ne tri vitet e fundit, ku disa prej tyre të jenë personel i kualifikuar me pesë viti përvojë pune pas diplomimit ,

një teknik i arkitekturës,

një teknik ndërtimtarisë drejtimi Hidro, një teknik të makinerisë,

një teknik elektrikistë

-si dhe punëtor të trajnuar

një fasader,

një murator

,nje saldues nje armirues,

nje skelistë,

nje suvatues

Dëshmia 5. Listën e punëtorëve të operatorit ekonomik, e njëjta duhet të dorëzohet origjinal ose kopje.

Për personelin e kualifikuar duhet të prezantohen diploma të shkollave profesionale të akredituara nga institucioni shtetërorë. Për punëtor të trajnuar duhet të prezantohen certifikatat e trajnimit nga institucione apo trupa certifikues të akredituara.

Dhe në ofertën e OE të rekomanduar gjendet lista e stafit me afro 45 punëtor/staf profesional dhe teknik, dhe lidhur me teknikët e pretenduar nga OE ankues, të njëjtit posedojnë certifikatën/diplomën nga MASHT për kryerjen e arsimit dhe aftësimin profesional SHMT drejtimi Makineri, dhe tjetra Elektroteknikë andaj bazuar në kërkesat e DT-së plotësohet kërkesa. Pretendimi i pa bazuar.

Si përfundim, OE ankues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka ofruar çmimin më të lirë për 1,572 euro se sa OE i rekomanduar, mirëpo i njëjti nuk ka plotësuar kërkesat sa i përket pajisjeve të kërkuara, andaj meqë i njëjti nuk ka dëshmuar me prova dhe argumente se i plotëson kërkesat si e tillë nuk merret e mirëqenë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të

gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“Roza Komani” B.I. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE“Roza Komani” B.I janë pjesërisht të bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi, Njoftimi mbi Vendimin e Autoriteti kontraktues, për aktivitetin e prokurimit me titull “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II”, me numër të prokurimit 634-25-10539-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues-Komuna Klinë.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i dates 24.12.2025, AK/Komuna Klinë, me të cilin ka rekomanduar operatorin ekonomik për dhënje të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Renovim dhe rindertim i hapsirave ne QKMF dhe AMF faza II”.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahës tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e

ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0025, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar , vendimin e OSHP-se dhe dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjeserishëm të ankesës të OE"Roza Komani" B.I SH.P.K , vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - Roza Komani B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: